



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI**

---

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_ . \_\_\_\_ . 2019

**V E N D I M**

**Nr. 130, Datë 01/10/2019**

Mbështetur në nenin 32, pika 1, gërma a), të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr. 112, datë 16.09.2019, e Z. E.C., ku pretendohet diskriminim, për shkak të “etnisë” dhe “përkatësisë në një grup të veçantë”, nga ana e Bankës së Shqipërisë.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi<sup>1</sup>,

**K O N S T A T O I:**

**I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.**

Sipas shpjegimeve të dhëna në formularin e ankesës, fillimisht ankuesi E.C.e informon Komisionerin, se në muajin qershor 2017, qeveria italiane shpalli falimentimin e Grupit Veneto Banca, nga ku u vendos që Intesa San Paolo Bank spa të përthithte pjesën e cilësuar si “*good bank*” të ish-Veneto Bank, e cila konsistonte në pjesën e performancës së mirë të bankave të këtij grupi, kapitalet, financimet, depozitat, asetet, hipotekat etj. Ndërkohë që, u vendos që një shoqëri italiane, që kishte si aktivitet të saj mbledhjen e borxheve të këqija, të merrte pjesën e ashtuquajtur “*bad bank*” të bankave të Grupit Veneto Banca. Shoqëria Italiane e Mbledhjeve të Borxheve quhet SGA spa, me seli në Napoli, Itali.

Z. E.C.ka qenë ish-punonjës i ish-Bankës Veneto në Shqipëri, që pas shkrirjes me Intesa San Paolo Bank, u largua nga puna si pasojë e procesit të ristrukturimit. Punonjësve të Veneto Bank u janë dhënë 2 (dy) zgjidhje, ku e para konsiston në fillimin e procedurave për zgjidhjen e

---

<sup>1</sup> Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën KMD.

kontratës së punës, si pasojë e pushimit kolektiv dhe opsioni i dytë konsiston në nënshkrimin e Marrëveshjes Reciproke për Përfundimin e Kontratës së Punës. Ankuesi ka zgjedhur opsionin e dytë duke nënshkruar Marrëveshjen e sipërpërmendur. Z. E.C. ishte kredimarrës pranë Veneto Bank. Në bazë të pikës 5, të Marrëveshjes Reciproke të lidhur ndërmjet Veneto Bank/Intesa San Paolo Bank dhe ankuesit, parashikohet se për punonjësit, që janë subjekt i pushimit kolektiv, të cilët do të nënshkruajnë marrëveshjen, ISBA do të aplikojë për kreditë ekzistuese termat dhe kushtet preferenciale që aktualisht janë në fuqi për stafin e ISBA-së. Marrëveshja është lidhur në datën 15.09.2018 dhe ka hyrë në fuqi në datën 19.10.2018.

Pas falimentimit të Veneto Bank, ankuesi shprehet se është vënë në dijeni të faktit, që kredia e tij është blerë nga SGA spa, që është një shoqëri italiane që funksionon dhe operon sipas legjislacionit italian, pasi nuk është e regjistruar në Shqipëri. Ankuesi pretendon se prona e tij e vendosur si kolateral pranë Veneto Bank sh.a. në Shqipëri, ka kaluar në favor të SGA spa, e cila ka kontraktuar Tranzit sh.p.k.(shoqëri shqiptare) të veprojë në emër të saj. Tranzit sh.p.k. ka patur si detyrë të njoftojë klientët, me qëllim që të paguajnë kreditë, që kanë marrë si financime pranë ish-Veneto Bank sh.a., tashmë e falimentuar. SGA spa është person juridik i huaj, i pa regjistruar në Shqipëri. Z. E.C. pretendon se SGA spa ka gjetur mbështetjen e Bankës së Shqipërisë, e cila nuk ka kryer ekspertizën e nevojshme, për të parandaluar pasojat e këtij procesi. Ai thekson faktin se Banka e Shqipërisë ka patur komunikime të vazhdueshme me Bankën e Italisë, që vërtetohen në informacionin që ka dhënë ky institucion, me shkresën nr. 4093/1, datë 28.08.2019, drejtuar Ministrisë së Drejtësisë dhe institucioneve të tjera. Referuar informacionit në fjalë, ankuesi pretendon se Banka e Shqipërisë ka dhënë miratimet përkatëse, duke lidhur edhe një Marrëveshje me SGA spa dhe Tranzit shpk, për “kreditë e këqija” të Veneto Bank. Ky proces ka patur pasojat negative për ankuesin në cilësinë e kredimarrësit.

Për sa më sipër, ankuesi E.C. pretendon se është diskriminuar nga Banka e Shqipërisë, për shkak të etnisë dhe përkatësisë në një grup të veçantë.

### **I. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.**

Hapat procedurialë të ndjekur nga strukturat përkatëse të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, paraqiten si më poshtë vijojnë:

**A.** Pas analizimit paraprak të ankesës, Komisioneri gjykoi se nevojitej informacion plotësues, për fillimin e shqyrtimit të saj. Për këtë arsye, KMD iu drejtua Z. E.C. me e-mailin e datës 24.09.2019, ku i kërkohej informacioni i cituar si më poshtë:

*1. “Në ankesën tuaj pretendohet diskriminim për shkak të "etnisë" nga Banka e Shqipërisë. Në kontekstin e çështjes së parashtruar nga ana juaj, është e nevojshme të*

*disponohet informacion mbi trajtimin e ndryshëm dhe më të favorshëm, që ky institucion u ka ofruar individëve të tjere me etni të ndryshme nga ajo juaja.*

2. *Në ankesën tuaj pretendohet diskriminim për shkak të "përkatësisë në një grup të veçantë". Lutemi të sqarohet qartësisht, se cilit grup të veçantë i përkisni, si dhe cilët janë grupet e tjerë, të cilëve, Banka e Shqipërisë u ka ofruar dhe garantuar trajtim të ndryshëm dhe më të favorshëm, sesa grupit ku ju pretendoni se bëni pjesë.*
3. *Kopje e shkresës përgjigje të Ministrisë së Drejtësisë, Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë, Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, drejtuar personit tuaj, pas shqyrtimit të çështjes së parashtruar”.*
4. *Informacion nëse dispononi vendime gjykate të formës së prerë, ku evidentohen shkeljet që ju pretendoni se ka kryer Banka e Shqipërisë.”*

Në përgjigje të e-mailit të dërguar nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Z. E.C.dërgoi e-mailin e datës 25.09.2019, ku parashtrohen edhe një herë pretendimet e tij, kundër subjektit Banka e Shqipërisë, të cilat janë të parashtruara edhe në ankesë.

Në vijim, në datën 26.09.2019, Z. E.C.dërgon me e-mail në adresë të KMD-së, kërkesë për tërheqje të ankesës së tij kundër Bankës së Shqipërisë.

### **PËR KËTË ARSYE:**

Mbështetur në nenin 94, pika 1, të Ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, nenin 1, nenin 7, pika 1, nenet 20 dhe 21, pika 1, nenin 32, pika 1, gërma a) e nenin 33, pikat 10-11, të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”,

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

## **V E N D O S I:**

1. Përfundimin e procedurës së shqyrtimit administrativ të ankesës nr. 112, datë 16.09.2019, së Z. E.C., pasi ky i fundit ka depozituar pranë KMD-së, kërkesë për tërheqje të ankesës.
2. Kundër këtij Vendimi lejohet ankim, brenda afateve ligjore, pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Robert GAJDA**

**KOMISIONER**

**Në mungesë dhe me porosi,  
DREJTORE JURIDIKE**

**Ardiana HALA**

Fusha – te mira dhe sherbime  
Shkak – etnia, perkatesi ne grup te vecante